

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Duka pret të dërguarin e Trump: I prezantova transformimin e futbollit shqiptar
ADRESA	https://www.cna.al/sport/duka-pret-te-derguarin-e-trump-i-prezantova-transformimin-e-futbollit-shqi-i473593
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:32:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e1f7aef0bcb9c99ab53a05d0dfd1eec5411f3062a95f591e4d884b1fe17a98e
TEKSTI	4d04efb2e65d8c5962dcd74707ce106c88cd45b3a513f96081948b18a269492a
PAMJA	921cb9824e7ed19b6ea9f9dbb01977667a9356ccb9dd4a4276720805ba9798e8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7bef9e50be2420847583664a4fd9d276e877b01ae8ec084a05cdcb8b3b8da604
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7bef9e50be2420847583664a4fd9d276e877b01ae8ec084a05cdcb8b3b8da604>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

21:06 Aktualitet

Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër p...

Duka pret të dërguarin e Trump: I prezantova transformimin e futbollit shqiptar



8 Shtator 2026, 17:53, Sport CNA



Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, priti në një takim Paolo Zampollin, të dërguarin special të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald

Trump, për Partneritetet Globale.

Zampolli ndodhet në Tiranë në kuadër të një vizite gjatë së cilës ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore, politikës dhe aktorë të ndryshëm në Shqipëri.

Gjatë takimit me Presidentin Duka, diskutimi u përqendrua te roli që sporti dhe veçanërisht futbolli mund të luajnë në diplomacinë sportive, në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në promovimin e imazhit të një vendi në arenën globale.

Presidenti Duka e njohu të dërguarin special me zhvillimin e futbollit shqiptar gjatë viteve të fundit, transformimin e infrastrukturës sportive, rritjen e standardeve të organizimit dhe përfaqësimin gjithnjë e më të rëndësishëm të Shqipërisë në kompeticionet dhe strukturat ndërkombëtare të futbollit.

Në këtë kontekst, u diskutua edhe rëndësia që ka përfaqësimi i Shqipërisë në institucionet drejtuese të futbollit evropian dhe botëror. Presidenti Armand Duka është një prej drejtuesve shqiptarë me përfaqësim të rëndësishëm në këto struktura, në detyrën e Zv. Presidentit të UEFA-s, si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, si edhe në FIFA, ku është anëtar i Komitetit të Federatave Anëtare.

"Sot prita në "Shtëpinë e Futbollit", Paolo Zampollin, të dërguarin special të Presidentit të SHBA, Donald Trump, për Partneritetet Globale.

Diskutuam mbi rolin e futbollit në diplomacinë sportive, përfaqësimin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe zhvillimin e futbollit shqiptar.

Ishte kënaqësi ta mirëprisja në "Shtëpinë e Futbollit" dhe t'i prezantoja nga afër transformimin që ka pësuar futbolli shqiptar", shkruan Duka.

Paolo Zampolli vlerësoi kontributin e Presidentit Duka në zhvillimin e futbollit shqiptar dhe rolin e tij në përfaqësimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke nënvizuar rëndësinë e sportit si një urë lidhëse mes vendeve dhe komuniteteve.

Në vijim të takimit, i dërguari special i Presidentit Trump zhvilloi edhe një vizitë në Shtëpinë e Futbollit, kompleksin modern sportiv të FSHF-së. Gjatë turit, Zampolli u njoh nga afër me ambientet dhe facilitetet që ofron kompleksi, duke shprehur përshtypjet e tij pozitive për investimin dhe standardet e infrastrukturës sportive.

Vizita në Shtëpinë e Futbollit i dha mundësinë Zampollit të shihe nga afër një prej projekteve më të rëndësishme të transformimit të futbollit shqiptar, që sot shërben si qendër e aktiviteteve të FSHF-së dhe si një hapësirë e rëndësishme për zhvillimin, edukimin dhe promovimin e futbollit në Shqipëri.





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Është Messi, por jo Ronaldo. Publikohet lista e "Topit të Artë"

Yamal thumbon: Nuk lutem për "Topin e Artë", Dembele shoku i Mbappe...

Vjen humbja e parë pas 47 ndeshjesh, shtanget Al Hilal

Asnjë minutë në tri ndeshjet e para, çfarë po ndodh me Pulisic

Ishte gati për rikthim te ish-skuadra në Europë, "kurthi" saudit ndal Benzema

Miqësore për kuqezinjtë, sfidojnë Ukrainën në Hungari

Kategoria e Parë, zgjidhet formacioni më i mirë i javës së parë

Rikthehet Champions League, vëmendja te Real-Inter. Mësoni 6 përballjet

Nuk kishte ndodhur kurrë, start historik nga Egnatia

Partizani-Dinamo dhe Skënderbeu-Tirana, vendosen stadiumet e ndeshjeve

Ndryshim drastik në Itali, "zhdukët" VAR-i

Reali me mungesa, Interi synon të thyjë tersin 27-vjeçar

[Dimarco mungon, si pritet të luajë Interi ndaj Realit](#)

[Delegacioni i UEFA-s mbërrin në Shqipëri, vizitë inspektuese në stadiumet e Euro-21](#)

[Barazimi ndaj Juventusit, Milani shfaq problemet. Cisse jep shpresë](#)

[Përplasje e ashpër dhe krizë, shkarkohet trajneri i parë në Serinë A. Zgjidhet pasuesi](#)

[Manaj “makineri” golash, shënojnë edhe Muçi me Asllanin. Si u paraqitën legjionarët](#)

[Dominon Egnatia, përzgjidhet formacioni i javës në Superiore](#)

[Milanit i ikën fitorja në fund, Juventusit barazon në shtesë](#)

[Dinamo fiton me përmbysje, Elbasani zhytet në krizë](#)

[editorial](#)

17:34 Editorial

[Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?](#)

CNA LIVESTREAM

22:32 | 25 shtator



kuriozitet

Turizmi ekologjik po përdoret në disa vende të Oqeanisë për të lidhur zhvillimin turistik me ruajtjen e natyrës

RRITJA E ÇMIMIT TË KARBURANTEVE

22:23 ▼
Bundestagu gjerman miraton zbritjen e taksës së karburantit, qeveria do të ulë taksat për benzinën e naftën me 0.17 euro për litër

MOTI SOT

PUSTEC: 10° / 17°

Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.